

## **Punëtori tematike në Tetovë**

Më 10 dhjetor të vitit 2008 në Tetovë u mbajt punëtori në temë “Plan aksionar për përmirësimin e pozitës së bashkësive që nuk janë shumicë në komunën e Tetovës”.

Në bazë të komunikimit të vazhdueshëm me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe pushtetin lokal në Tetovë u identifikua nevoja për organizimin e një punëtorie e cila dot ketë për qëllim përcaktimin e problemeve dhe nevojave dhe përfshirjen e tyre në një propozim plan aksionar për përmirësimin e pozitës së bashkësive etnike që nuk janë shumicë të cilët jetojnë në territorin e komunës së Tetovës.

Në punëtori morën pjesë gjithsej 36 pjesëmarrës: Zëvendës avokati i popullit nga zyra rajonale në Tetovë – Drita Selmani, 10 përfaqësues nga pushteti lokal (këshilltarë, të punësuar dhe anëtarë të Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në komunën e Tetovës), përfaqësues nga Qendra për punësim, 25 përfaqësues nga organizata joqeveritare të cilët punojnë në përmirësimin dhe avancimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe 3 gazetarë

Të pranishmit u njoftuan me bazat e planifikimit strategjik dhe operativ, përcaktimin e prioriteteve sipas metodologjisë SMART dhe përdorimin e veglave në këtë metodologji. Në pjesën praktike u përgatitën plane aksionare në lëmit me prioritet: arsim, punësim dhe kulturë. Planet aksionare u përpiluan në dokument të posaçëm dhe u dërguan deri te të gjithë pjesëmarrësit në punëtori me qëllim që të vijon një iniciativë konkrete për realizimin e nevojave ku do të përfshihen të gjitha palët e prekura. Ekipi i projektit edhe më tutje do të punon në koordinimin e aktiviteteve dhe do ta ndjek periudhën e aktiviteteve vijuese.

Punëtorinë e udhëhoqën Mario Veljković dhe Fatmir Saraçini, kurse u organizua nga Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me organizatën partnere “Vlera të përbashkëta” nga Shkupi.